



## **VENDIMI MBI PRANUESHMËRI**

**Data e miratimit: 11 dhjetor 2019**

**Nr. i lëndës: 2016-09**

**Milorad Trifunović**

**kundër**

**EULEX-it**

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur më 11 dhjetor 2019, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Z. Guénaël METTRAUX, kryesues  
Znj. Anna BEDNAREK, anëtare  
Znj. Anna AUTIO, anëtare

Ndihmuar nga:

Z. Ronald Hooghiemstra, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në pajtim me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit, e ndryshuar për herë të fundit më 15 janar 2019,

### **I. PROCEDURA PRANË PANELIT**

1. Ankesa në këtë rast është regjistruar më 30 qershor 2016.
2. Me shkresën e datës 1 korrik 2016, Paneli ka informuar Misionin se kjo lëndë ishte regjistruar.
3. Më 28 qershor 2017, Paneli i ka kërkuar këtij dhe ankuesit të ofronte informata në lidhje me ankesën e tij. Ankuesi fillimisht u përgjigj përmes përfaqësuesit për familjet serbe të Qendrës së Burimeve të Personave të Zhdukur (QBZh), një OJQ me qendër në Prishtinë, se ai nuk kishte informacion të mëtejshëm në lidhje me këto raste.
4. Më 20 shtator dhe 17 tetor 2017, Paneli i ka dërguar dy kërkesa shtesë përmes përfaqësuesit të lartpërmendur të QBZh-së.
5. Më 20 tetor 2017, Paneli ka pranuar një përgjigje nga përfaqësuesi i ankuesve i QBZh-së duke ofruar informata shtesë lidhur me dy raste, duke përfshirë edhe këtë të tanishmin.

6. Më 8 dhjetor 2017, Paneli ia ka dërguar një deklaratë të fakteve dhe pyetjeve shefit të Misionit (ShM-së), EULEX-i Kosovë, duke e ftuar atë që të parashtojë përgjigjet e saj dhe vërejtjet me shkrim mbi ankesat jo më vonë se me datën 26 janar 2018.
7. Përmes letrës së datës 19 janar 2019, nga Misioni ishte kërkuar përsëri që të japë përgjigje për pyetjet deri më 16 shkurt 2019.
8. Vërejtjet e ShM-së u morën më 12 mars 2019, pas së cilës u janë komunikuar ankuesve për vërejtje shtesë.
9. Më 15 mars 2019, letra e ShM-së i ishte dorëzuar ankuesve për informim, të cilëve iu ishte dhënë afat deri më 15 prill 2019 për të bërë ndonjë parashtrësë të mëtejshme në përgjigje të asaj letre.
10. Më 19 qershor 2019, Paneli e ka lëshuar vendimin e tij të pranueshmërisë në këtë rast, duke e shpallur ankesën të pranueshme në lidhje me nenet 2, 3, 8 dhe 13 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (këtu e tutje, "Konventa Evropiane" ose "Konventa") (<https://hrrp.eu/alb/docs/Decisions/2019-06-19%20Admissibility%20Decision%202016-09-a%20pdf%20version.pdf>).
11. Përveç kësaj, në vendimin e tij të pranueshmërisë, Paneli ftoi palët të adresojnë pyetjet e mëposhtme:

#### **I. PËR SHEFEN E MISIONIT:**

- i. A i ishin shpërndarë ndonjëherë dosjet që kishin të bënin me këtë rast, në posedim të Institutit të Forenzikës, prokurorëve të EULEX-it? Nëse jo, cila është arsyeja?
- ii. Cilat hapa (nëse ka ndonjë) janë marrë nga Misioni për të siguruar bashkërendimin ndërmjet organeve të ndryshme të tij për të centralizuar dhe shpërndarë informatat që kanë të bëjnë me hetimin në vazhdim e sipër të veprave të rënda penale, përfshirë rastet e "zhdukjeve me forcë"?
- iii. A është misioni kompetent për të monitoruar këtë rast pa autoritetet vendore që kanë filluar një hetim për të? Nëse jo, çfarë është i autorizuar Misioni të bëjë kur, sipas mendimit të tij, autoritetet vendore dështojnë të përmbushin obligimet e tyre procedurale sipas nenit 2 ose 3 të Konventës?
- iv. Gjithashtu ju lutemi të ofroni një kopje të letrës së datës 5 nëntor 2018 që përcjell transferimin e lëndëve tek autoritetet e Kosovës.
- v. Në parashtrësat e veta, Misioni ka dhënë shenja se "është konsideruar jo e mundur që hetimet e mëtejshme nga policia do të siguronin informata të mjaftueshme" (shih, më lart, paragrafin 26). Cilat ishin faktorët apo konsideratat që çuan deri në atë përfundim? Nga kush është bërë kjo dhe kur?
- vi. Në parashtrimet e tij (të përmbledhura në paragrafin 21 më lart), Misioni tregon se si rezultat i rikonfigurimit të NJHKL-së në vitin 2014, kapacitetet e inteligjencës dhe hulumtimit ishin *fshinë*. Kush e mori atë vendim? Bazuar në çfarë faktorë dhe konsiderata?

## II. PËR ANKUESIN:

- i. Çfarë kontaktesh keni pasur me Misionin e EULEX-it gjatë periudhës 2008-2014 në lidhje me këtë rast? Në veçanti, cila ishte natyra dhe niveli i kontakteve tuaja me Institutin Mjeko-Ligjor të EULEX-it?
- ii. A jeni informuar se në vitin 2009, EULEX-i Kosovë vendosi të mbyllë çështjen që ka të bëjë me zhdukjen e nëntë punëtorëve të minierës, duke përfshirë edhe të afërmin tuaj?
- iii. Ju lutemi përshkruani efektin - financiar, personal dhe emocional – që zhdukja e të afërmit tuaj ka pasur mbi ju.

## II. PËRBËRJA E PANELIT

12. Pas dorëheqjes së një prej anëtarëve të tij të përhershëm, anëtari në largim u zëvendësua nga znj. Autio me emërimin e saj në Panel në përputhje me rregulloren 14 të rregullores së punës së Panelit. Për të siguruar që të familjarizohet plotësisht me lëndën, znj. Autio u njoh me gjithë dosjen e lëndës, përfshirë pranueshmërinë e saj, dhe për këtë arsye është plotësisht në gjendje të marrë pjesë në diskutimet e kësaj lënde.

## III. FAKTET

13. Faktet e paraqitura nga ankuesi mund të përmbliidhen si më poshtë.
14. Më 22 qershor 1998, Miroslav Trifunović, vëllai i ankuesit, Milorad Trifunović, ka shkuar në punë me autobus në minierën e Belaçevcit, Komuna e Fushë Kosovës. Ai dhe tetë punonjës të tjerë u kapën nga pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) në fshatin Graboc i Poshtëm, komuna e Fushë Kosovës. Miroslav Trifunović dhe punonjës të tjerë u urdhëruan të dilnin jashtë nga autobusi dhe u morën në një drejtim të panjohur. Q1ë nga atëherë nuk është dëgjuar më gjë nga ai.
15. Ankuesi dhe familja e tij njoftuan Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (KNKK), Misionin Ndërkombëtar Civil (ICM), "Zyrën e SHBA" (kuptohet si referencë ndaj përfaqësimit diplomatik të SHBA-së në Prishtinë), Qendrën Kulturore në Prishtinë dhe Ministrinë e Brendshme të Republikës së Serbisë dhe KNKK-në në Serbi, për zhdukjen e Miroslav Trifunovićit.

## IV. PARASHTRESAT E PALËVE

### Ankuesi

16. Siç përmbliidhet më lart, ankuesi pretendon se gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv, EULEX-i Kosovë duhej të kishte hetuar zhdukjen e vëllait të tij dhe ka dështuar ta bëjë këtë në kundërshtim me të drejtat themelore të tij dhe vëllait të tij.

### Shefi i Misionit ("ShM")

17. Më 19 shtator 2019, Paneli pranoi parashtresat e ShM-së lidhur me meritat e kësaj lënde.

18. Si çështje paraprake, ShM-ja sqaroi se, në kundërshtim me ato që parashtrimet e mëparshme mund të kishin sugjeruar, megjithëse shumica e dokumenteve nga UNMIK-u u pranuan nga Instituti i Mjekësisë Ligjore, disa prej këtyre dokumenteve - të cilat specifikisht nuk janë identifikuar nga Misioni - ishin marrë gjithashtu nga Njësia e Hetimit të Krimeve të Luftës të EULEX-it (NjHKL). Sidoqoftë, ShM-ja shton se “pasi ato nuk ishin pjesë e dosjes së NjQHP-së, ato nuk u shqyrtuan nga prokurori i PSRK-së i EULEX-it”. Mbi këtë bazë, ShM-ja tregoi se do të tërhiqte sugjerimin e saj të mëparshëm se nuk kishte asnjë indikacion që NjHKL-ja e EULEX-it Kosovë kishte pranuar dosjen e përmendur.

19. Në përgjigje të pyetjes së Panelit nëse dosjet në posedim të Institutit të Mjekësisë Ligjore iu shpërndanë prokurorëve të EULEX-it, ShM-ja pretendon se do të duket se prokurorët e Misionit nuk ishin në dijeni rreth ekzistencës së dosjeve në posedim të Institutit të Mjekësisë Ligjore në lidhje me këtë rast dhe duhet të ketë supozuar se ato posedonin të gjitha shënimet përkatëse. “Do të dukej”, tha Misioni “që në atë kohë, njësitet e ndryshme të EULEX-it nuk ishin në dijeni që dokumentet që kishin të bënin me të njëjtat ngjarje dhe/ose individë ishin ndarë në dosje të ndryshme dhe regjistroheshin nën numra të ndryshëm të dosjeve”.

20. Paneli më tutje ka pyetur

‘Cilat hapa (nëse ka pasur) janë ndërmarrë nga Misioni për të siguruar bashkërendimin midis organeve të ndryshme të tij për të centralizuar dhe shkëmbyer informacione që kanë të bëjnë me hetimin e vazhdueshëm të veprave të rënda penale, përfshirë rastet e ‘zhdukjes me forcë’?’

21. Si përgjigje, ShM-ja parashtroj si vijon:

‘Si praktikë e përgjithshme, sa herë që NjHKL-ja dhe prokurorët e EULEX-it në PSRK po hetonin raste, ata kontaktonin njësitet e tjera për të përcaktuar nëse ekzistonte ndonjë informacion shtesë. Kjo praktikë mund të jetë ndjekur në një masë më të vogël në fazën fillestare të Misionit’.

22. Misioni nuk kërkon të adresojë pse kjo praktikë ‘e përgjithshme’ siç duket nuk u ndjek në këtë rast. Misioni shtoj se do të duket se në gjysmën e parë, dhe si rezultat i numrit të madh të lëndëve në ardhje, rishikimi dhe vlerësimi i dosjeve të UNMIK-ut ‘ishte bazuar kryesisht (...) në atë që tashmë ekzistonte në dosjen e lëndës’.

23. Në pyetjen nëse Misioni është kompetent për të monitoruar këtë rast pa u filluar ndonjë hetim për të nga autoritetet vendore, ShM-ja nuk i drejtohet qartë pyetjes së Panelit dhe nuk specifikoj nëse do të ishte në gjendje të monitorojë këtë rast të veçantë. Përkundrazi, ai ofron një përshkrim të përgjithshëm të natyrës së funksionit dhe mandatit të tij monitorues. Sidoqoftë specifikon që lëndët e zgjedhura janë ose mund të monitorohen “nga faza hetimore deri në ekzekutimin e dënimit”.

24. Paneli gjithashtu vëri në dyshim më tej pohimin e Misionit se e ka konsideruar të pamundur që hetimi i mëtutjeshëm të ofronte informacion të mjaftueshëm rreth lëndës në mënyrë që ajo të ec përpara. Përgjigja e Misionit është e shkurtër në specifika. Sugjeron që është mirëkuptimi që ky konkluzion ishte arritur në mënyrë të pavarur nga prokurori i PSRK-së mbi bazën e vlerësimit të dhënë nga NjHKL-së:

‘Përfundimi i tillë ishte arritur në kontekstin e përgjithshëm dhe në rrethanat e përgjithshme të përshkruara në faqet 2-9 të përgjigjeve të EULEX-it për rastin e datës 12 mars 2019. Është e ligjshme të supozohet se nëse numri i lëndëve dhe dokumenteve të dorëzuara nga UNMIK-u të kishte qenë dukshëm më i ulët dhe i

organizuar siç duhet, prokurori mund të kishte zgjedhur të fillonte një hetim, në vend që ta hedhtë poshtë kallëzimin penal në bazë të informacionit që përmban dosja e NjQHP-së’.

25. Lidhur me *fshirjen* e inteligjencës dhe aftësive kërkimore të Misionit në vitin 2014, Misioni tha se “ka të ngjarë që ky vendim ishte marrë (nga vendet anëtare të BE-së) duke marrë parasysh ndryshimet e vitit 2014 në mandatin e EULEX-it”.
26. ShM-ja më tej konstaton që një vlerësim i përgjegjësisë së Misionit sipas nenit 2 (pjesët procedurale) dhe nenit 3 të Konventës Evropiane “nuk mund që mos të merret parasysh konteksti dhe rrethanat në të cilat Misioni u thirr për të zbatuar mandatin e tij”. Misioni theksoi më tej një numër sfidash me të cilat u përballën në atë kohë, duke përfshirë numrin e lëndëve për të adresuar, gjendjen e dosjeve të pranuar nga UNMIK-u, kufizimet e burimeve, afatin kohor të mandatit të tij dhe hapat e ndërmarrë nga Misioni për të organizuar të dhënat e marra nga UNMIK-u. Me rëndësi të veçantë për këtë lëndë, Misioni bën parashtrësit e mëposhtme, të cilat Paneli i përsërit fjal për fjalë:

‘Duket se dy vendime kanë ndikuar në qasjen fillestare të policisë dhe njësive të prokurorisë së Misionit: nga njëra anë dhënja përparësi e rishikimit dhe shqyrtimit të rreth 1.200 dosjeve të lëndëve që tashmë ishin emëruar nga UNMIK-u” si ‘dosje të krimeve të luftës’ mbi të ashtuquajturat ‘dosjet e personave të zhdukur; dhe nga ana tjetër, identifikimi i shpejtë i atyre rasteve të krimeve të luftës që shfaqeshin më premtuese për sa i përket rezultateve të hetimit. Kjo çoi në hedhjen poshtë të kallëzimeve penale që kanë të bëjnë me krime për të cilat asnjë i dyshuar specifik nuk mund të identifikojë bazuar në informacionin në dosje, dhe kur u konsiderua e pamundur që hetimi i mëtejshëm nga policia mund të ofronte informacion të mjaftueshëm. Sidoqoftë, fakti që Misioni nuk e hetoi zhdukjen e Miroslav Trifunoviçit nuk kishte asnjë ndikim në lidhje me përpjekjet për të gjetur vendndodhjen ose mbetjet e tij nga stafi i Misionit në IFM. Në të vërtetë, përderisa lënda penale ishte piushuar në vitin 2009 nga prokurori i NjHKL-së së EULEX-it, lënda në IFM kishte vazhduar paralelisht dhe nuk ishte mbyllur. Gjatë dhjetë viteve të kaluara, EULEX-i me aftësinë e tij të ekspertëve në IFM ka ndërmarrë përpjekje të mëdha për të gjetur Miroslav Trifunoviçin dhe tetë personat e tjerë të zhdukur. Këto përpjekje filluan qysh në vitin 2008, kur u krye puna e parë e gjurmimit për një gjurmim më të madh (hartimi i një strategjie, sigurimi i fondeve nga donatorët ndërkombëtarë dhe sigurimi i bashkëpunimit të institucioneve të Kosovës). Siç tregohet tashmë në përgjigjet dhe vërejtjet e Misionit të datës 12 mars 2019, këto përpjekje arritën kulmin në gjurmimet e gjata 6 mujore të kryera midis 2011 dhe 2012 në Zhillivodë, në një sipërfaqe prej rreth 2000 metra katrorë dhe deri në thellësinë rreth 25 metra. Për fat të keq nuk u gjetën mbetje. Nëse do të gjendeshin mbetjet, është e ligjshme të supozohet se hetimi penal me siguri se do të kishte rifilluar.

27. Misioni gjithashtu specifikon që nën mandatin e tij aktual të rikonfiguruar, Misioni ruan një kapacitet ekzekutiv për të mbështetur IML-në e Kosovës:

‘Nëse zbulohen informacione të reja të besueshme, Misioni është i gatshëm të mbështesë institucionet e Kosovës në çdo operacion shtesë për të gjetur z. Milorad Trifunovic dhe të zhdukurit e tjerë”.

28. Misioni shton si në vijim:

Misioni pranon që njësitë e tij të policisë dhe prokurorisë mund dhe duhet të ishin më të zellshëm kur merreshin me dosjen e NjHKL-së. Në përgjithësi, Misioni duhet të ketë bërë më shumë përpjekje për të mbajtur viktimat dhe publikun më të gjerë të

informuar në lidhje me strategjitë dhe qasjet e tij, me qëllim që të trajtojë pritjet në mënyrë sa më të duhur dhe të jetë më transparent. Sidoqoftë, në rastin konkret dhe duke marrë në konsideratë pengesat themelore të paraqitura, Misioni nuk beson se të drejtat e ankuesit janë shkelur dhe në bazë të asaj që u përmend më lart thekson se Misioni bëri atë që ishte në mënyrë të arsyeshme e mundur për të konstatuar fatin e Milorad Trifunovicit.

29. Më në fund, më 6 nëntor 2019, një anëtar i Sekretariatit të Panelit iu dha qasje në letrën e Misionit të datës 5 nëntor 2018 që i ishte bashkëngjitur transferimit të dosjes që i përket këtij rasti tek autoritetet vendore. Një prej këtyre dokumenteve, Vendimi për të hedhur poshtë Raportin Penal të 20 korrikut 2009 tregoi se kallëzimi penal në lidhje me hetimin e zhdukjes së të afërmit të ankuesit ishte hedhur poshtë nga PSRK-ja për arsye të mëposhtme:

'Nga raporti penal del qartë se nuk ekziston dyshimi i arsyeshëm ndaj një të dyshuari specifik për veprën penale të përshkruar më sipër. Për më tepër, prokurori beson se nuk është e mundshme që hetimi i mëtutjeshëm nga policia të sigurojë informacion të mjaftueshëm.'

30. Paneli ishte gjithashtu në gjendje që në atë kontekst të rishikojë letrën e dorëzimit të cilën EULEX-i i kishte bashkëngjitur këtë dosje kur ia kishte bartur atë autoriteteve vendore më 5 nëntor 2018. Letra thoshte që përkundër se lënda ishte hedhur poshtë më 20 korrik 2009,

'Sidoqoftë, unë e ftoj zyrën tuaj që vetë të shqyrtoj dosjen e lëndës, pasi ta pranoj, dhe të kontaktoj NjHKL-në në mënyrë që të verifikojë nëse ata janë akoma në posedim të ndonjë materiali tjetër që i përket kësaj lënde.'

#### **Parashtrësasat e mëtejshme nga ankuesi**

31. Asnjë parashtrim tjetër nuk u pranua nga ankuesi.

### **V. SHYQRTIMET**

#### **“Zhdukja me forcë” si shkelje e rëndë e të drejtave themelore të viktimave**

32. Praktika e zhdukjes me forcë është një nga llojet më të ashpra të shkeljeve të të drejtave të njeriut. Ato përfshijnë shkeljen e jo një lloji të së drejtës, por shumë, duke përfshirë në shumë raste, të drejtën e së vërtetës, të drejtën e njohjes si person para ligjit, të drejtën e lirisë dhe sigurinë e personit dhe të drejtën për të mos iu nënshtuar torturës dhe trajtimit ose dënimit tjetër mizor, çnjerëzor ose poshtëruës, e drejta për një mjet efektiv juridik dhe sjellja e tillë shkel ose përbën një kërcënim të rëndë për të drejtën e jetës. Shihni, p.sh., Sadiku-Syla kundër EULEX-it, 2014-34, Vendim dhe gjetje, 19 tetor 2016, par. 33; S.H. kundër EULEX-it, Vendimi dhe Gjetjet, çështja nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 61; Deklaratë për mbrojtjen e të gjithë personave nga zhdukja e detyruar, A/RES/47/133, 18 dhjetor 1992.
33. Veçanërisht e rëndësishme në këtë kontekst është e drejta e ankuesit për të vërtetën, d.m.th., e drejta e viktimave që të dinë se çfarë ndodhi me të afërmit e tyre të afërt dhe rrethanat në të cilat të afërmit e tyre janë zhdukur. Shihni, në përgjithësi, S.H. kundër EULEX-it, Vendimi dhe Gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 Shtator 2019, par. 62; Desanka dhe Zoran Stanisić kundër EULEX-it, 2012-22, 11 nëntor 2015, par. 67; shih gjithashtu El-Masri kundër Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Aplikacioni nr. 39630/09,

Aktgjykimi i GjEDNj-së i 12 dhjetor 2012, paragrafët 191-193; Orhan kundër Turqisë, Aplikacioni nr. 25656/94, Aktgjykimi i GjEDNj-së i datës 18 qershor 2002, par. 358; Imakayeva kundër Rosisë, Aplikacioni nr. 7615/02, Aktgjykimi i GjEDNj-së i datës 9 nëntor 2006, paragrafi 164; Velásquez Rodríguez kundër Honduras, aktgjykim i datës 29 korrikut 1988, par. 181; Heliodoro Portugal kundër Panama, aktgjykimi i datës 12 gusht 2008, par. 244; Anzualdo Castro kundër Perusë, gjykimi i 22 shtatorit 2009, par. 116-118; Komenti i Përgjithshëm mbi të Drejtën e të Vërtetës në Marrëdhënien ndaj Zhdukjes me forcë, Raporti i Grupit të Punës për Zhdukjet me forcë ose të pavullnetshme, 2010, në veçanti, par. 1, Dokumenti A/HRC/16/48; Vendosja e parimeve për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut përmes veprimeve për të luftuar ndëshkimin (E/CN.4/2005/102/Add.1), në veçanti, Parimet 2-4; dhe, gjithashtu, Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të gjithë Personave nga Zhdukja me forcë, e miratuar më 20 dhjetor 2006, në veçanti, Preambula dhe neni 24(2); dhe për një ilustrim, rasti i Gudiel Alvarez e tutje ("Diario Militar") kundër Guatemalës (Aktgjykimi i datës 20.11.2012; Meritat, riparimet dhe kostot), par. 301 (dhe referencat e cituara).

34. Për gati dy dekada, ankuesi ka jetuar me pasiguri në lidhje me fatin e vëllait të tij, çfarë i ndodhi atij dhe në çfarë rrethanash ishte zhdukur ai. Vuajtjet psikologjike që vijnë nga kjo nuk janë vetëm të mëdha; po janë duke vazhduar. Shihni gjithashtu S.H. kundër EULEX-it, Vendimi dhe Gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 63; D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX-it, 2014-11 deri 2014-17, Vendimi për pranueshmërinë, 30 shtator 2015, par. 78; Sadiku-Syla kundër EULEX-it, 2014-34, Vendim mbi pranueshmërinë, 29 shtator 2015, paragrafët 35 dhe 42. Shih gjithashtu, në kontekstin e nenit 3, GjEDNj, Kurt kundër Turqisë, aktgjykimi i datës 25 maj 1998, Raporte të Vendimeve dhe Vendimeve 1998 III, paragrafët. 130-34; Khadzhaliev dhe të tjerët kundër Rosisë, Aplikacioni nr. 3013/04, aktgjykim i 6 nëntorit 2008, par. 120-121; Timurtas kundër Turqisë, Aplikacioni nr. 23531/94, Aktgjykimi i datës 13 qershor 2000, par. 95; Rezoluta nr. 828 e vitit 1984, paragrafi 3 (Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës); dhe Komenti i Përgjithshëm për nenin 17 të Deklaratës, Raportin e Grupit të Punës për Zhdukjet me forcë ose të pavullnetshme 2000. Dokumenti E/CN.4/2001/68 (referuar dhe komentuar në nenin 17(1) të Deklaratës për Mbrojtjen e të Gjithë Personat nga Zhdukja me forcë).
35. Natyra e vazhdueshme e shkeljes së të drejtave të përfshira në një rast të tillë shpjegon se detyra e autoriteteve kompetente për të hetuar këto raste është një detyrim i ngutshëm dhe i rëndësishëm që mund të lihet anash ose vonohet në rrethanat tejet të ngushta. Shih S.H. kundër EULEX-it, Vendimi dhe Gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 64.
36. Kur bëhet fjalë për hetimin e rasteve të zhdukjes me forcë, një hetim duhet të fillohet sa më shpejt që të jetë e mundur dhe vonesat të shgmangen sa më shumë që të jetë e mundur. Kjo jo vetëm për shkak të efektit të pasigurisë tek të afërmit që mbijetojnë. Kjo është gjithashtu për shkak se provat do të zhduken ose do të humbasin dhe kujtesa venitet. Prandaj vonesat në hetime mund të ndikojnë negativisht në mundësinë e një hetimi që përcakton rrethanat në të cilat një person është zhdukur dhe të sjell fajtorët para drejtësisë. Për ilustrime të zbatimit të kësaj garancie në kontekste të ndryshme, shihni përgjithësisht: S.H. kundër EULEX-it, Vendimi dhe Gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 65; Gürtekin dhe të tjerët kundër Qipros, Vendimi i GjEDNj-së i papranueshmërisë i datës 11 mars 2014; Al-Skeini dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar [GC], Aplikacioni nr. 55721/07, Aktgjykimi i GjEDNj-së i datës 7 korrikut 2011; Jaloud kundër Hollanda [GC], Aplikacioni nr. 47708/08, Aktgjykimi i GjEDNj-së i datës 20 nëntor 2011; Jeliç kundër Kroacisë, Aplikacioni nr. 57856/11, Aktgjykimi i GjEDNj-së i datës 12 qershor 2014; B. dhe të tjerët kundër Kroacisë, Aplikacioni nr. 71593/11, Aktgjykimi i GjEDNj-së i datës 18 qershor 2015; Palić kundër Bosnje dhe Hercegovinës, Aplikacioni nr. 4704/04, Aktgjykimi i GjEDNj-së i datës 15 shkurt 2011; Lejla Fazlić dhe

të tjerët kundër Bosnje dhe Hercegovinës dhe 4 të tjerë, nr. 66758/09, 66762/09, 7965/10, 9149/10 dhe 12451/10, Aktgjykimi i GjEDNj-së i datës 3 qershor 2014; Mujkanović dhe të tjerët kundër Bosnje dhe Hercegovinës, Aplikacioni nr. 47063/08 e tutje, Vendimi i GjEDNj-së i papranueshmërië i datës 3 qershor 2014; Nježić dhe Štimac kundër Kroacisë, Aplikacioni nr. 29823/13, Aktgjykimi i GjEDNj-së i datës 9 prill 2015.

### **Detyrat dhe detyrimet e autoriteteve në lidhje me veprimet e zhdokjes me forcë**

37. Veprimet e prokurorëve dhe policisë së EULEX-it janë pjesë e mandatit ekzekutiv të EULEX-it në sektorin e drejtësisë, policisë dhe doganave. Si të tilla, ato janë në kuadër të mandatit të Panelit (shih për shembull, K në T kundër EULEX-it, 2013-05 deri 2013-14, 21 prill 2015, paragrafi 43; Kriç kundër EULEX-it, 2012-21, 26 gusht 2014, paragrafi 23; Y kundër EULEX-it, 2011-28, 15 nëntor 2012, paragrafi 35). Ky është rasti nëse sjellja themelore në fjalë përbëhet nga një akt pozitiv ose ndonjë dështim me faj. Shih Krić kundër EULEX-it, 26 gusht 2014, par. 25; S.H. kundër EULEX-it, Vendimi dhe Gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 48.
38. Paneli tashmë ka pasur rastin të vërejë se Misioni i EULEX-it nuk është shtet dhe se aftësia e tij për të garantuar mbrojtje efektive të të drejtave të njeriut nuk mund të krahasohet në të gjitha aspektet përkatëse me atë që mund të pritët nga një shtet (shih p.sh. Vendimi i Panelit në A, B, C, D kundër EULEX-it, 2012-09 deri 2012-12, 20 qershor 2013, paragrafi 50; K në T kundër EULEX-it, cituar më lart, paragrafi 53; shih gjithashtu Panelin Këshillues për të Drejtat e Njeriut, Vendimi i UNMIK-ut (PKDNj) në lëndët nr. 248/09, 250/09 dhe 251/09, 25 prill 2013, paragrafi 35; SH kundër EULEX-it, Vendimi dhe Gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, paragrafi 49).
39. Pritjet e vëna mbi aftësinë e EULEX-it për të hetuar dhe zgjidhur lëndët komplekse penale duhet të jenë realiste dhe të mos i vihet EULEX-it ndonjë barrë disproporcionale që mandati dhe burimet e tij nuk mund të pritët në mënyrë të arsyeshme që të përmbushen (LO kundër EULEX-it, 2014-32, Vendimi dhe Gjetjet, 11 nëntor 2015, paragrafët 43 dhe 45, dhe referencat e tij në: Vendimi i Panelit në A, B, C, D kundër EULEX-it, 2012-09 deri 2012-12, 20 qershor 2013, paragrafi 50; K në T kundër EULEX-it, 2013-05 deri 2013-14, 21 prill 2015, paragrafi 53; Sadiku-Syla kundër EULEX-it, 2014-34, Vendim për pranueshmërinë, 29 shtator 2015, paragrafët 35-37; DW, EV, FU, GT, Zlata Veselinović, HS, IR kundër EULEX-it, 2014-11 deri 2014-17, Vendim mbi pranueshmërinë, 30 shtator 2015, paragrafët 72-74; shih gjithashtu vendimin e PKDNj-së në lëndën nr. 248/09, 250/09 dhe 251/09, 25 prill 2013, paragrafi 35 dhe paragrafët 70-71).
40. Prandaj, në secilin rast, Paneli pritët të rishikojë nëse kishte pengesa konkrete dhe reale që mund të kishin minuar aftësinë e EULEX-it për të kryer një hetim të shpejtë dhe efektiv të një lënde. Një vlerësim i tillë nuk ka për qëllim të justifikojë mangësitë operacionale që nuk lidhen me sfidat konkrete dhe demonstruese. L.O. kundër EULEX-it, 2014-32, Vendim dhe gjetje, 11 nëntor 2015, par. 44; S.H. kundër EULEX-it, Vendimi dhe Gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 50.
41. Në çdo rast, në raste të veçanta të këtij serioziteti, autoritetet hetimore pritët të veprojnë me një kujdes dhe arsyeshmëri të arsyeshme dhe të investojnë burime në përpjesëtim me domosdoshmërinë dhe mundësinë e zgjidhjes së lëndës. Përderisa asnjë autoritet hetimor nuk mund të pritët të zgjidhë të gjitha rastet e paraqitura para tij, ai pritët të veprojë me aq kujdes, shpejtësi dhe efektivitet, që pasqyron rëndësinë e lëndës nën hetim (LO kundër EULEX-it, 2014-32, Vendim dhe gjetje, 11 nëntor 2015, paragrafët 46 dhe 59; shih gjithashtu Varnava dhe të tjerët kundër Turqisë, Aplikacioni nr. 16064/90 e tutje, gjykimi i datës 18 shtator 2009, paragrafi 191; Palić kundër Bosnje dhe Hercegovinës, Aplikacioni nr. 4704/04, aktgjykimi i datës 15 shkurt 2011, paragrafi 63;



SH kundër EULEX-it, Vendimi dhe gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, paragrafi 54).

42. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka përcaktuar një numër parimesh të përgjithshme që japin udhëzime në lidhje me atë që kërkon ligji i të drejtave të njeriut dhe pret një hetim efektiv mbi pretendimet e shkeljeve të të drejtave sipas nenit 2 të Konventës Evropiane (Mustafa Tunç dhe Fecire Tunç kundër Turqisë, Aplikacioni nr. 24014/05, Aktgjykimi, 14 prill 2015 (Dhoma e Madhe), paragrafët 169ff):

“169. ... Hetimi duhet të jetë, ndër të tjera, i plotë, i paanshëm dhe i kujdesshëm (shih McCann dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar, 27 shtator 1995, 161-163 §§, Seria A nr. 324).

170. Forma e hetimit që kërkohet nga ky detyrim ndryshon në varësi të natyrës së shkeljes së jetës: megjithëse një hetim penal është përgjithësisht i domosdoshëm kur vdekja shkaktohet me dashje, procedurat civile apo edhe disiplinore mund të plotësojnë këtë kërkesë kur vdekja ndodh si rezultat i pakujdesisë (shih ndër të tjera, Calvelli dhe Ciglio kundër Italisë, cituar më lart, § 51; Mastromatteo kundër Italisë [GC], nr. [37703/97/97](#), § 90, ECHR 2002 VIII; dhe Vo kundër Francës, cituar më lart, 90)).

171. Duke i kërkuar shtetit të ndërmarrë hapat e duhur për të mbrojtur jetën e atyre që janë nën juridiksionin e tij, neni 2 i imponon obligim këtij shteti të sigurojë të drejtën e jetës duke vendosur dispozita efektive të ligjit penal për të penguar kryerjen e veprave penale kundër personit, i mbështetur nga makineria e zbatimit të ligjit për parandalimin, shtypjen dhe ndëshkimin e shkeljeve të dispozitave të tilla. Ky detyrim kërkon nënkuptim se duhet të ketë një formë të hetimit zyrtar efektiv kur ekziston arsye për të besuar se një individ ka pësuar lëndime të rrezikshme për jetën në rrethana të dyshimta, madje edhe kur kryesi i supozuar i sulmit fatal nuk është agjent i shtetit (shiko Menson kundër Mbretërisë së Bashkuar (vendim), nr. [47916/99](#), ECHR 2003-V; Pereira Henriques kundër Luksemburgut, nr. [60255/00](#), 56., 9 maj 2006; dhe Yotova kundër Bullgarisë, nr. [43606/04/04](#), § 68, 23 tetor 2012).

172. Në mënyrë që të jetë "efektive" pasi kjo shprehje do të kuptohet në kontekstin e nenit 2 të Konventës, fillimisht një hetim duhet të jetë adekuat (shih Ramsahai dhe të tjerët kundër Hollandës [GC], nr. [52391/99](#), § 324, KEDNJ 2007 II). Kjo do të thotë, ajo duhet të jetë e aftë të çojë në vërtetimin e fakteve dhe, kur është e përshtatshme, identifikimin dhe dënimin e atyre që janë përgjegjës.

173. Detyrimi për të kryer një hetim efektiv është një detyrim jo i rezultatit por i mjeteve: autoritetet duhet të marrin masat e arsyeshme në dispozicion të tyre për të siguruar prova në lidhje me incidentin në fjalë (shih Jaloud kundër Hollandës [GC], nr. [47708/08](#), 186 §, KEDNJ 2014; dhe Nachova dhe të tjerët kundër Bullgarisë [GC], nr. [43577/98](#) dhe [43579/98](#), 160, ECHR 2005 VII).

174. Në çdo rast, autoritetet duhet të ndërmarrin çfarëdo hapi të arsyeshëm për të siguruar provat në lidhje me incidentin, duke përfshirë, ndër të tjera, dëshminë e dëshmitarit okular, provat mjekoligjore dhe, kur është e përshtatshme, një autopsi e cila siguron një regjistrim të plotë dhe të saktë të lëndimit dhe një analizë objektive e gjetjeve klinike, përfshirë shkakun e vdekjes. Çfarëdo mangësie në hetim që minon aftësinë e tij për të vendosur shkakun e vdekjes ose personin përgjegjës do të rrezikojë të dëmtojë këtë standard (shih Giuliani dhe Gaggio kundër Italisë [GC], nr. [23458/02](#), § 301, KEDNJ 2011).

175. Në veçanti, përfundimet e hetimit duhet të bazohen në një analizë të plotë, objektive dhe të paanshme të të gjithë elementëve përkatës. Mosrespektimi i një

linje të qartë hetimi dëmton në një masë vendimtare aftësinë e hetimit për të vendosur rrethanat e çështjes dhe, kur është e përshtatshme, identitetin e atyre që janë përgjegjës (shih Kolevi kundër Bullgarisë, nr. [1108/02](#), § 201, 5 nëntor 2009).

176. Sidoqoftë, natyra dhe shkalla e shqyrtimit që plotësojnë pragun minimal të efektivitetit të hetimit varen nga rrethanat e lëndës së veçantë. Nuk është e mundur të zvogëlohet larmia e situatave që mund të ndodhin në një listë kontrolli më themelor të akteve të hetimit ose kriterëve të tjera të thjeshtuara (shih Tanrikulu kundër Turqisë [GC], nr. [23763/94](#), §§ 101-110, KEDNJ 1999-IV; dhe Velikova kundër Bullgarisë, nr. [41488/98](#), § 80, KEDNJ 2000 VI).

177. Për më tepër, personat përgjegjës për hetime duhet të jenë të pavarur nga kushdo që implikohet ose ka të ngjarë të përfshihet në ngjarje. Kjo nënkupton jo vetëm mungesën e lidhjes hierarkike ose institucionale, por edhe një pavarësi praktike (shih Anguelova kundër Bullgarisë, nr. [38361/97](#), 138 §, KEDNJ 2002 IV).

178. Domosdoshmëria për shpejtësi dhe përshpejtim të arsyeshëm në këtë kontekst nënkuptohet (shih Al-Skeini dhe të tjerët, cituar më lart, 167).

179. Për më tepër, hetimi duhet të jetë i qasshmëm për familjen e viktimës në masën e nevojshme për të mbrojtur interesat e tyre legjitime. Duhet të ketë gjithashtu një element të mjaftueshëm të një kontrolli publik të hetimit, shkalla e të cilit mund të ndryshojë nga rasti në rast (shih Hugh Jordan kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. [24746/94](#), § 109, KEDNJ 2001 III). Megjithatë qasja e domosdoshme e publikut ose e të afërmeve të viktimës, mund të parashikohet në faza të tjera të procedurës (shih, midis autoriteteve të tjera, Giuliani dhe Gaggio, të cituar më lart, 304; dhe McKerr kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 28883/95, 129 §, KEDNJ 2001 III).

180. Neni 2 nuk i detyron autoritetet hetuese të plotësojnë çdo kërkesë për një masë të veçantë hetimore të bërë nga ndonjë i afërm gjatë hetimit (shih Ramsahai dhe të tjerët, cituar më lart, 348 §; dhe Velcea dhe Mazëre kundër Rumanisë, nr. [64301/01](#), 113 §, 1 dhjetor 2009).

181. Pyetja nëse një hetim ka qenë mjaftueshëm efektiv duhet të vlerësohet në bazë të të gjitha fakteve përkatëse dhe në lidhje me realitetet praktike të punës hetimore (shih Dobriyeva dhe të tjerët kundër Ruisë, nr. [18407/10](#), 72 §, 19 dhjetor 2013; dhe Qendra për Burime Ligjore në emër të Valentin Câmpeanu kundër Rumanisë [GC], nr. [47848/08](#), 147 §, 17 korrik 2014).

43. Gjykata Evropiane ka nxjerrë në pah një element tjetër të rëndësishëm të një hetimi kompatibel me të drejtat e njeriut, gjegjësisht, nevojën që autoritetet hetimore të kërkojnë ndihmën dhe bashkëpunimin e autoriteteve të tjera nëse dhe kur këto të fundit mund të kenë në zotërimin e tyre informacione dhe/ose burime të rëndësi për përpjekjet e mëhershme për të kryer një hetim efektiv. Në përgjithësi shih lëndën *Güzelyurtlu dhe të tjerët kundër Qipros dhe Turqisë*, Aplikacioni nr. 36925/07, Aktgjykimi, 29 janar 2019, paragrafët 229 dhe 232-233:

“229. Hulumtimi i mësipërm i praktikës gjyqësore tregon se në shumicën e rasteve në të cilat Gjykata deri më tani ka shqyrtuar mos bashkëpunimin ose mos kërkesën për bashkëpunim midis shteteve në çështjet transnacionale, ajo e ka bërë këtë kur vlerëson pajtueshmërinë e përgjithshme nga shteti në fjalë me detyrimin e saj procedural për të hetuar në bazë të nenit 2. Në këto raste mos bashkëpunimi ishte vetëm një aspekt midis të tjerëve në shqyrtimin e Gjykatës të efektivitetit të hetimit të kryer nga shteti në fjalë, përgjithësisht si dështim për

të kërkuar bashkëpunim nga një shtet tjetër (për shembull, Qipro në Rantsev, cituar më lart, 241 §, dhe Aliyeva dhe Aliyev, cituar më lart, 78 §), përfshirë këtu atë bashkëpunim nënkupton mundësinë e transferimit të procedurave në një shtet tjetër (shih Huseynova, cituar më lart, 111). Gjykata ka trajtuar posaçërisht dështimin për të bashkëpunuar ose ndihmuar në një hetimi të kryer brenda juridiksionit të një shteti tjetër kontraktues në shumë pak raste, përkatësisht në *O'Loughlin, Cummins dhe Rantsev* (shih paragrafët 223 dhe 225 më lart).

[...]

232. Gjykata më parë ka vendosur që gjatë interpretimit të Konventës duhet t'i kushtohet vëmendje karakterit të veçantë si traktat për zbatimin kolektiv të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore (shih *Irlanda kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 18 janar 1978, § 239, Seria nr. 25, duke iu referuar Preambulës së saj; *Loizidou kundër Turqisë* (kundërshtimet paraprake), të cituara më lart, 70 §; dhe *Nada kundër Zvicrës [GC]*, nr. [10593/08](#), § 196, KEDNJ 2012). Ky karakter kolektiv, në disa rrethana specifike, mund të nënkuptojë një detyrë për shtetet kontraktuese të veprojnë së bashku dhe të bashkëpunojnë në mënyrë që të mbrojnë të drejtat dhe liritë që ata kanë ndërmarrë për të siguruar brenda juridiksionit të tyre (shih për shembull, në fushën ndërkufitare të trafikimit të qenieve njerëzore sipas nenit 4 të Konventës, Rantsev, cituar më lart, 289)). Në rastet kur një hetim efektiv mbi një vrasje të paligjshme që ndodh brenda juridiksionit të një shteti kontraktues kërkon përfshirjen e më shumë se një shteti kontraktues, Gjykata konstaton se karakteri i veçantë i Konventës si traktat përmbartim kolektiv përfshin në parim një detyrim nga ana e shteteve të interesuara të bashkëpunojnë në mënyrë efektive me njëri-tjetrin në mënyrë që të sqarohen rrethanat e vrasjes dhe të sjellin para drejtësisë autorët.

233. Prandaj Gjykata mendon se neni 2 mund të kërkojë nga të dy shtetet një detyrim të dyanshëm për të bashkëpunuar me njëri-tjetrin, duke nënkuptuar në të njëjtën kohë një detyrim për të kërkuar ndihmë dhe një detyrim për të ofruar ndihmë. Natyra dhe shtrirja e këtyre detyrimeve në mënyrë të pashmangshme do të varet nga rrethanat e secilit rast veç e veç, për shembull nëse gjërat kryesore të dëshmimeve janë të vendosura në territorin e shtetit kontraktues në fjalë ose nëse të dyshuarit kanë ikur atje”.

44. Lidhur me çështjen e shpejtësisë, Paneli dëshiron të vën re sa vijon. Lidhur me detyrimet e tij hetimore, Misioni ishte i obliguar nën mandatin e tij hetimor të hetonte pretendimet e besueshme për shkeljet e të drejtave të njeriut me zell dhe shpejtësi, dhe të sigurojë në të gjitha rastet që përgjigja hetimore e Misionit të jetë në përpjesëtim me rëndësinë e çështjes. Si përmbledhje, përgjigja duhet të jetë e tillë që të garantojë mbrojtje efektive të të drejtave në fjalë. Shih në përgjithësi, S.H. kundër EULEX-it, Vendimi dhe Gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 56; Sadiku-Syla kundër EULEX-it, 2014-34, 19 tetor 2016, par. 36. Shih gjithashtu Varnava dhe të tjerët kundër Turqisë, Aplikacioni nr. 16064/90 e tutje, gjykimi i dates 18 shtator 2009, par. 191; Oğur kundër Turqisë, Aplikacioni nr. 21594/93, aktgjykimi i dates 20 maj 1999, par. 88; Hugh Jordan kundër Mbretërisë së Bashkuar, Aplikacioni nr. 24746/94, Aktgjykimi i dates 4 maj 2001, par. 105-09; Douglas-Williams kundër Mbretërisë së Bashkuar, Aplikacioni nr. 56413/00, Vendim i dates 8 janar 2002.
45. Kur detyrimi i shtetit ose autoritetit përfshin një detyrë për të hetuar, domosdoshmëria për shpejtësi vlen për të gjitha fazat dhe aspektet e hetimit: nxitjen e tij, sjelljen e tij dhe përfundimin e tij. Domosdoshmëria për shpejtësi për nga natyra është relative: varet nga rrethanat e secilit rast, në veçanti sfidat e paraqitura nga lënda, vështirësitë për t'iu qasur dëshmitarëve ose për të mbledhur informacion. S.H. kundër EULEX-it, Vendimi dhe Gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 57. Por sfidat dhe vështirësitë hetimore nuk justifikojnë zvarritjen, vonesat ose ngadalësimin e pajustificueshme në kryerjen e detyrave hetimore. Kjo është një shprehje e të drejtës më të gjerë për

procedurat pa vonesa të panevojshme, e cila u garantohet të gjitha palëve në procedurë gjyqësore. Shih përsëri, *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe Gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 57. Paneli ka theksuar kështu që –

“E drejta për një seancë dëgjimore të ndershme dhe publike brenda një kohe të arsyeshme siç kuptohet në nenin 6 (1) të Konventës është krijuar për të mbrojtur” të gjithë palët në proces gjyqësor ... ndaj vonesave të tepërta procedurale ... Përveç kësaj, në çështjet penale e drejta është e dizajnuar për të shmangur që një person i ngarkuar të mbetet shumë gjatë në gjendje të pasigurisë në lidhje me fatin e tij “[...]” (*Maksutaj kundër EULEX-it*, 2014-18, 12 nëntor 2015, paragrafi 57, citimet e tij janë nga *Stögmüller kundër Austrisë*, Aplikacioni nr. 1602/62, aktgjykimi i datës 10 nëntor 1969, paragrafi 5; i përsëritur në *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe Gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, paragrafi 57).

46. Gjatë vlerësimit, në një rast të veçantë, arsyeshmëria e kohës së marrë nga autoritetet për të hetuar shkeljet e pretenduara të të drejtave, një numër faktorësh janë identifikuar si veçanërisht të rëndësishëm, përfshirë këto: (1) kompleksitetin e lëndës, (2) sjellja e aplikantit, dhe (3) sjellja e administratës kompetente (*Maksutaj kundër EULEX-it*, 2014-18, 12 nëntor 2015, paragrafi 58, dhe referencat e saj për *König kundër FRG*, Aplikacioni nr. 6232/73, aktgjykimi i datës 28 qershor 1978, paragrafi 99, *Pedersen dhe Baadsgaard kundër Danimarkës*, Aplikacioni nr. 49017/99, aktgjykim i datës 17 dhjetor 2004, paragrafi 45; shih gjithashtu, *Thomas Rüsche kundër EULEX-it*, 2013-21, 11 janar 2017, par. 59-65; *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, paragrafi 58). Një shqyrtim i pasojës së vonesave të palëve të përfshira gjithashtu mund të sigurojë prova përkatëse të arsyeshmërisë ose përndryshe të vonesave në proces (*Maksutaj kundër EULEX-it*, 2014-18, 12 nëntor 2015, paragrafët 64-66 dhe referencat e cituara; *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe Gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, paragrafi 58).
47. Një angazhim dhe lidhje e rreptë ndaj këtyre standardeve është veçanërisht e rëndësishme për një mision të sundimit të ligjit, siç është EULEX-i Kosovë, që ka për qëllim të shërbejë si një shembull i angazhimit të shoqërisë për t'i dhënë fund mosndëshkimit dhe ndërtimin në të të një ndjenje llogaridhënieje për shkelje serioze të të drejtave. Shih *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe Gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 55. Çfarëdo standardi që nuk ka këtë që u përmend më sipër do të rrezikonte krijimin e një ndjenje të pajtimit me pandëshkueshmërinë dhe mosrespektimin e kërimit të drejtësisë dhe përgjegjësisë nga viktimat (*S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe Gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, paragrafi 55; *L.O. kundër EULEX-it*, 2014-32, Vendimi dhe gjetjet, 11 nëntor 2015, paragrafi 46; *Sadiku-Syla kundër EULEX-it*, 2014-34, Vendimi dhe gjetjet, 19 tetor 2016, paragrafi 37; shih gjithashtu *Varnava dhe të tjerët kundër Turqisë*, Aplikacioni nr. 16064/90 e tutje, vendimi i datës 18 shtator 2009, paragrafi 191; *Palić kundër Bosnje dhe Hercegovinës*, Aplikacioni nr. 4704/04, aktgjykimi i datës 15 shkurt 2011, paragrafi 63; Vendimi i PKDNj-së në lëndët nr. 248/09, 250/09 dhe 251/09, 25 prill 2013, paragrafi 80).
48. Gjithashtu, duhet të theksohet këtu se të drejtat që i nënshtrohen kësaj ankese janë ndër më të rëndësishmet nga të gjitha të drejtat themelore. Ato prekin interesat thelbësore të viktimave të pretenduara dhe duhet të garantohen në të gjitha rrethanat. Praktika e zhdukjes me forcë përbën një shkelje të ashpër të këtyre të drejtave. Ndër të tjera kjo reflektohet në faktin se praktika e “zhdukjes me forcë” tani vlerësohet dhe karakterizohet si një krim kundër njerëzimit, në veçanti, në Statutin e Gjykatës Penale Ndërkombëtare (Statuti i Romës, neni 7(1)(i)) dhe në Ligjin për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (Ligji Nr.05/L-053) (neni 13(1)(i)). Shih gjithashtu *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe Gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 59.

49. Implikimet e ndryshimeve në mandatin e Misionit pas mbylljes së Misionit në qershor 2018 dhe implikimet e tij për qëllimin e këtij rasti janë adresuar shkurtimisht më poshtë.

### **Rastet e “zhdukjes me forcë” në kontekstin e mandatit të Misionit**

50. ShM-ja nuk kundërshton që Misioni ishte kompetent për të hetuar këtë çështje dhe se mund ta kishte bërë këtë gjatë ushtrimit të kompetencës së tij juridiksionale.
51. Paneli tashmë ka përcaktuar se këto lloje të lëndëve hyjnë brenda mandatit ekzekutiv dhe kompetencës hetimore/prokuroriale të Misionit. Shih, për shembull, D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX-it, 2014-11 deri 2014-17, Vendim për pranueshmërinë, 30 shtator 2015; Sadiku-Syla kundër EULEX-it, 2014-34, Vendimi për pranueshmërinë, 29 shtator 2015; Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX-it, 2014-11 deri 2014-17, Vendimi për pranueshmërinë, 30 shtator 2015; L.O. kundër EULEX-it, 2014-32, Vendim dhe gjetje, 11 nëntor 2015; S.H. kundër EULEX-it, Vendimi dhe Gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019.
52. Kur veprime të tilla si zhdukja me forcë janë kryer në kontekstin e përgjithshëm të një konflikti të armatosur, siç ishte rasti këtu, sjellja në fjalë mund të cilësohet si një krim lufte, krime kundër njerëzimit ose krime me bazë etnike mbi të cilat Misioni kishte kompetencë specifike dhe të shprehur juridiksionale nën mandatin e tij të atëhershëm të zbatueshëm. Shih në përgjithësi, nenin 3 (d) të veprimit të përbashkët të Këshillit. Shih gjithashtu Sadiku-Syla kundër EULEX-it, 2014-34, 19 tetor 2016, par. 44-46. Në D.W. e tutje Paneli tha si në vijim në marrëdhëniet me këtë çështje:

'Ekzistonte një mundësi shumë reale që ato krime dhe shkeljet shoqëruese të të drejtave të bazoheshin në konsiderata etnike ose fetare, duke shkuar kështu më tej në territorin juridiksional mbi të cilin Misioni ka kompetencë. Në një mjedis pas konfliktit ku marrëdhëniet etnike dhe fetare mund të jenë ende të tensionuara dhe të brishta, raste të tilla janë përparësi të dukshme hetimore.'

Shih D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., dhe I.R. kundër EULEX-it, 2014-11 deri 2014-17, 19 tetor 2016, par. 83 e tutje, në veçanti par. 85.

53. Hetimi i këtij lloji të rasteve jo vetëm që ishte pjesë e mandatit të Misionit, por ishte një element themelor dhe thelbësor i tij. Në L.O. kundër EULEX-it, Paneli nënvizoi që -

'Mund të ketë pak argumente se hetimi i fatit të të zhdukurve - pavarësisht fesë apo përkatësisë etnike - duhet të jetë dhe duhet të mbetet një përparësi operative për EULEX-in si Mision për Sundimin e Ligjit për të cilin duhet të sigurohen burime të përshtatshme'.

L.O. kundër EULEX-it, lënda nr. 2014-32, Vendimi dhe Gjetjet, 11 nëntor 2015, par. 47. Shih gjithashtu S.H. kundër EULEX-it, Vendimi dhe Gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019.

54. Konsideratat e mësipërme do të shërbejnë për të vlerësuar përpjekjet e bëra nga Misioni në lidhje me këtë rast dhe nëse këto përpjekje mund të thuhet se janë në përputhje me mandatin e përgjithshëm të Misionit dhe detyrimet e tij ndaj të drejtave të njeriut.

**Rrethanat në të cilat Misioni ishte për të përmbushur përgjegjësitë e tij ndaj të drejtave të njeriut**

55. Për arsye të përshkruara më lart, Misioni nuk duhet të vlerësohet në përputhje me standardet e përsosmërisë. Ai u përball në atë kohë me një mjedis sfidues pas konfliktit. Burimet e tij ishin të kufizuar dhe këto ishin në disa aspekte të papërshtatshme për detyrën dhe pritjet. Kjo kërkonte që Misioni të bënte zgjedhje dhe të prioritzonte përpjekje të caktuara mbi të tjerët.
56. Për më tepër, mënyra me të cilën UNMIK-u ka kryer përpjekjet e veta hetimore dhe mënyrën se si i ka transferuar dosjet e saj në EULEX e ndërlikoi shumë punën e Misionit. Si përgjigje, Misioni investoi kohë, burime dhe energji për të rishikuar ato regjistrime dhe duke u përpjekur t'i kuptojë ato. Për këto përpjekje, Misioni duhet të lavdërohet.
57. Në vlerësimin e ankesës së tanishme, Paneli ka marrë parasysh vështirësitë e përfshira domosdoshmërisht në hetimin e krimeve të luftës në një shoqëri pas konfliktit, siç është Kosova (*L.O. kundër EULEX-it*, 2014-32, 11 nëntor 2015, paragrafi 44 dhe referencat e cituara në të; *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, paragrafi 51; shih gjithashtu *Palić kundër Bosnje dhe Hercegovinës*, aplikacioni nr. 4704/04, aktgjykimi i datës 15 shkurt 2011, paragrafi 70; dhe vendimi i PKDNj-së në lëndën nr. 248/09, 250/09 dhe 251/09, cituar më lart, paragrafët 44 dhe 62 e tutje). Sidoqoftë, këto vështirësi nuk duhet të shërbejnë për të kamufluar ose për të justifikuar dështimet hetimore që nuk janë në asnjë mënyrë domethënëse të lidhura me vështirësitë e përmendura. Prandaj Paneli do të vlerësojë në secilin rast nëse një hap i veçantë hetimor që ishte normalisht i hapur për EULEX-in do të ishte bërë jopraktik nga arsyet që lidhen me rrethana pas konfliktit, të pavarura nga ato që kryejnë hetimin (*L.O. kundër EULEX-it*, 2014-32, Vendim dhe Gjetjet, 11 nëntor 2015, paragrafi 44; *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, paragrafi 51).
58. Veçanërisht e rëndësishme në vlerësimin e përshtatshmërisë së përgjigjes së Misionit është fakti që aftësia e tij për të përmbushur detyrimet e veta - hetimore - është ndikuar nga të dy rrethanat e përgjithshme në të cilat janë kryer krimet dhe nga sjellja e UNMIK-ut pas këtyre krimeve. Krimet e kryera në kontekstin e një konflikti të armatosur janë pothuajse gjithmonë një sfidë për të hetuar. Sfida shpesh mbetet pas përfundimit të një konflikti sepse dëshmitë mund të shkatërrohen dhe gatishmëria dhe aftësia e dëshmitarëve për të dhënë informacion mund të zvogëlohet në mënyrë të konsiderueshme në një kontekst të tillë. Paneli ka marrë parasysh rregullisht këto sfida kur ka bërë vlerësimin e vet për përgjigjen e Misionit. Shih përsëri, *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe Gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, paragrafët 52-53.
59. Paneli gjithashtu ka marrë në konsideratë faktin se EULEX-i Kosovë duhej të ballafaqohej dhe adresonte trashëgiminë hetimore të UNMIK-ut. Nga të dhënat e kësaj lënde – dhe lëndëve të tjera që janë paraqitur para Panelit - duket se UNMIK-u dështoi në aspekte të ndryshme në përmbushjen e detyrimeve të veta ndaj të drejtave të njeriut në lidhje me viktimat e “zhdukjeve me forcë”. Kjo u vu re siç duhet nga Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut i Kombeve të Bashkuara, i cili përcaktoi që UNMIK-u kishte shkelur të drejtat e viktimave të veprimeve të tilla në disa raste. Llogaritja e duhur, e zellshëm dhe e organizuar e informacionit që ka të bëjë me kryerjen e shkeljeve të tilla serioze të të drejtave është një element i rëndësishëm i mbrojtjes efektive të këtyre të drejtave. Në bazë të natyrës dhe peshës së veprave në fjalë, praktika e ruajtjes së shënimeve të UNMIK-ut ishte e papërshtatshme. Paneli nuk do t'i imponojë mangësitë dhe defektet e Misionit që do të vëhen mbi UNMIK-un. Paneli ka marrë parasysh ato rrethana kur vlerëson sjelljen e Misionit dhe sfidat me të cilat përballlet. *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe Gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 53.

#### **Gjetjet në lidhje me dështimet e pretenduara të Misionit**

60. Siç u përmend më lart, nuk ka dyshim që Misioni ka vepruar në rrethana të vështira për pjesën më të madhe të kohës në fjalë në lidhje me këtë rast.
61. Nga procesverbali i kësaj lënde është gjithashtu e qartë se Misioni ndërmori një numër hapash të rëndësishëm për këtë ankesë. Në veçanti, ai ndërmori hapa aktiv për të shqyrtuar dhe organizuar të dhënat e marra nga UNMIK-u. Dhe Instituti i Mjekësisë Ligjore u përfshi drejtpërdrejt në përpjekjen për të gjetur të afërm të ankuesit ose eshtrat e tij.
62. Sidoqoftë, këto përpjekje nuk kanë bërë mjaft për të mbrojtur dhe garantuar efektivitetin e të drejtave themelore të ankuesit dhe vëllait të tij. Paneli ka identifikuar një numër mangësish në sjelljen e Misionit që kanë rezultuar ose kontribuar në shkeljen e të drejtave të ankuesit:
  - i. Një dështim për të hetuar plotësisht dhe me zell lëndën, duke përfshirë *ndër të tjera* një dështim të bashkërendimit të duhur ndërmjet organeve të Misionit; dhe
  - ii. Një dështim për të përfshirë në mënyrë të mjaftueshme dhe informuar të afërmit për të zhdukurit.

### Hetimi i zhdukjes së të afërmit të ankuesit

63. Si çështje paraprake, Paneli dëshiron të nxjerrë në pah dallimin midis çështjes së kompetencës për të hetuar dhe asaj të një detyrimi për ta bërë këtë. Kompetenca e Misionit për të hetuar krimet që përfshijnë shkeljen e të drejtave të caktuara të njeriut - dhe qëllimin e tyre - është përcaktuar nga një radhitje e ligjeve vendore, në veçanti, Ligji mbi Juridiksionin në përsëritjet e tij të ndryshme. Sa i përket detyrimit të Misionit për të hetuar këto, kjo nuk lind nga këto dispozita që përcaktojnë kompetencën juridiksionale të prokurorëve të EULEX-it mbi këto raste, por nga nenet 2 dhe 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (dhe dispozita të ngjashme për të drejtat e njeriut), të cilat mandatojnë Misioni për të garantuar efektivitetin e këtyre të drejtave në kontekstin e funksionit të tij ekzekutiv. Shih p.sh. *D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX-it*, 2014-11 deri 2014-17, 30 shtator 2015, paragrafët 84 etj. Shih gjithashtu, për një ilustrim të zbatimit të këtij nocioni të përgjithshëm: lënda e *Gudiel Alvarez e tutje ("Diario Militar") kundër Guatemalës* (Aktgjykimi i datës 20.11.2012; Meritat, riparimet dhe kostot), në veçanti, par. 192, 231-232. Shih gjithashtu *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe Gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 83.
64. Për përmbushjen e mandatit të tij ekzekutiv, Misioni është i detyruar të interpretojë kompetencat e tij - natyrën dhe fushën e tij - në përputhje dhe në një mënyrë të qëndrueshme me detyrimet e tij ndaj të drejtave të njeriut. Paneli së pari do të shqyrtojë çështjen e kompetencës së Misionit për të hetuar raste të tilla si ajo në shqyrtim e sipër.
65. Deri më 15 prill 2014, EULEX-i Kosovë kishte kompetencë të papenguar për të hetuar këto lloj lëndësh (shih Ligjin Nr. 03/L-053 mbi Juridiksionin, Zgjedhjen e Lëndëve dhe Ndarjen e Lëndëve Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it Kosovë, neni 3 dhe Ligji Nr. 03/L-052 në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës). Paneli tashmë ka theksuar në vendimet e kaluara se kjo lloj krimesh mund të - dhe, në të vërtetë, në disa raste, - hetohet si krime lufte ose krime të motivuara etnike. Prandaj, nga fillimi i mandatit të tij deri në prill 2014 (d.m.th., përfshirë periudhën pas liritimit, 2007-2014), Misioni ishte me të vërtetë kompetent për të hetuar ose vazhduar hetimin e këtij rasti. Shih *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe Gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 85.
66. Më 15 prill 2014, fushëveprimi i kompetencës së prokurorëve të EULEX-it u ngushtua dhe u kufizua në "lëndët në vazhdim e sipër", d.m.th., raste që ishin hapur nga EULEX-i



para kësaj kohe (shih Ligjin nr. 04/L-273 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve në lidhje me mandatin e EULEX-it, neni 3.3). Paneli vën re si në vijim sa i përket periudhës midis prillit 2014 dhe qershorit 2018: Së pari, vendimi nëse do të hapet apo jo një lëndë e re e vendosur me prokurorët e EULEX-it (në bashkëpunim me autoritetet vendore kompetente) ku ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme. Prandaj, vendimi për të mos hapur ose rihapur hetimin e këtij rasti ishte marrë - në mënyrë të shprehur ose implicite - nga prokurorët e EULEX-it. Shih gjithashtu *X. dhe 115 të tjerë kundër EULEX-it*, lënda nr. 2011-20, Vendimi dhe Gjetjet, 22 prill 2015, paragrafët. 60-67; *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe Gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 86.

67. Së dyti, ai detyrim për të hetuar duhet të interpretohet në bazën e detyrimeve të Misionit ndaj të drejtave të njeriut nën OPLAN. Duke marrë parasysh që shkelja e të drejtave të viktimave dhe e ankuesit ishte në vazhdim e sipër, i ka ra Misionit që të siguroj që ato të drejta të mbroheshin në mënyrë efektive dhe shkelja e tyre të korrigjohej siç duhej.
68. Për më tepër, Ligji mbi Juridiksionin i zbatueshëm gjatë asaj periudhe (prill 2014 - qershor 2018) përmbante një klauzolë me të cilën Misioni mund të ushtronte kompetencë mbi lëndët (d.m.th, ato që nuk ishin “në vazhdim e sipër” që nga maji 2014) ku ekzistonin “rrethana të jashtëzakonshme”. Paneli tashmë ka pasur rastin ta interpretojë këtë nocion. Ai e ka interpretuar atë në një mënyrë që i jep efekt përgjegjësive së përgjithshme të Misionit për të garantuar mbrojtje efektive të të drejtave të njeriut në kontekstin e mandatit të tij ekzekutiv. Kështu, në *Sadiku-Syla*, Paneli ka thënë si vijon:

“ShM-ja pohon se legjislacioni i ri që ka hyrë në fuqi më 17 maj 2014” ka zvogëluar në mënyrë të konsiderueshme mundësinë që prokurorët dhe gjykatësit e EULEX-it të ushtrorjnë funksione ekzekutive në lëndët e reja (“Përgjigja, faqja 6, duke iu referuar Ligjit Omnibus që ka amenduar Ligjin mbi Juridiksionin). Megjithatë Paneli vëren se neni 7(A) parashikon “Autoritetin e prokurorëve të EULEX-it në rrethana të jashtëzakonshme”: “Në rrethana të jashtëzakonshme një lëndë do t’i caktohet një prokurori të EULEX-it me një vendim të përbashkët të autoritetit kompetent të kryeprokurorit të Shtetit dhe EULEX-it KOSOVË. “ShM-ja nuk ka arritur të shpjegojë pse kjo dispozitë nuk do të sigurojë një bazë të përshtatshme juridike mbi të cilën duhet të veprojnë prokurorët e EULEX-it, veçanërisht në një rast të tillë si ky tani, kur autoritetet vendore nuk duket se po kryejnë hetimr. Paneli do t’i ftonte palët të adresojnë këtë çështje nëse dëshirojnë të bëjnë parashitja shtesë në lidhje me meritat e këtij rasti”.

Shih *Sadiku-Syla kundër EULEX-it*, 2014-34, 29 shtator 2015, par. 62. Shih gjithashtu, *D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX-it*, 2014-11 deri 2014-17, 30 shtator 2015, par. 90; *Sadiku-Syla kundër EULEX-it*, 2014-34, 19 tetor 2016, par. 23 e tutje; *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe Gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 88.

69. Në të kundërt, nga procesverbali i lëndëve që vijnë pranë Panelit - duke përfshirë edhe atë aktual - është e qartë se EULEX-i ka dështuar në shumë raste ta trajtojë këto lloje të lëndëve si përparësi hetimore ose, të paktën, për t’ia përshtushtuar kohën dhe burimet e nevojshme për të kryer hetime me kohë dhe në mënyrë efektive të atyre rasteve. Shih, p.sh., *Sadiku-Syla kundër EULEX-it*, 2014-34, Vendimi për pranueshmërinë, 29 shtator 2015, paragrafët. 34- 39; *D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX-it*, 2014-11 deri 2014-17, Vendimi për pranueshmërinë, 30 shtator 2015, paragrafët. 72-76; *L.O. kundër EULEX-it*, 2014-32, Vendim dhe gjetje, 11 nëntor 2015, paragrafët 43- 47, dhe 59-65; *Sadiku-Syla kundër EULEX-it*, 2014-34, Vendim dhe gjetje, 19 tetor 2016, paragrafët 47; *D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX-it*, 2014-11 deri 2014-17, Vendim dhe gjetje, 19 tetor 2016, par. 58, 60,



62-65, 81-82; dhe *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe Gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 89.

70. Në këtë rast të veçantë, Misioni pranoi dështimin e tij për të hetuar këtë lëndë. Sidoqoftë, theksoi se Instituti i Mjekësisë Ligjore ishte dhe mbeti i përfshirë në këtë çështje për mjaft kohë (shih, *supra*, paragrafët 26 dhe 27). Përfshirja e Institutit të Mjekësisë Ligjore në këtë çështje vërtetë është për t'u përshëndetur dhe shkoi në njëfarë mënyre drejt përmbushjes së detyrimeve të Misionit. Sidoqoftë përgjegjësia e Institutit të Mjekësisë Ligjore ishte thjesht forenzike në kuptimin e kërkimit të gjetjes dhe identifikimit të mbetjeve të të afërmeve të ankuesit. Kjo nuk kualifikohet ose plotëson kriterin që autoritetet duhet të hetojnë dhe sqarojnë rrethanat në të cilat një individ ishte zhdukur dhe t'i çojë ata që janë përgjegjës para drejtësisë.
71. Në këtë kuptim, përderisa Misioni ndërmori disa hapa drejt përmbushjes së detyrimeve të tij në këtë rast, këto përpjekje nuk ishin të mjaftueshme për të përmbushur standardet e të drejtave të njeriut të përcaktuara më lart që ishin të detyrueshme për Misionin në atë kohë.
72. Paneli vëren gjithashtu se mungesa e prioriteteve të qarta mund të ketë ndikuar negativisht në aftësinë e Misionit për t'u përqëndruar në raste të këtij lloji. Gjithashtu për të ardhur keq është mbështetja e Misionit në klasifikimin e lëndëve nga ana e UNMIK-ut si lëndë të hapura/të mbyllura dhe krime lufte/raste të personave të zhdukur. Klasifikimi i lëndëve nga ana e UNMIK-ut duket se është kryer pa një hetim të plotë dhe të duhur të lëndëve që janë përpjekur ose janë kryer së pari dhe në shumë raste të afërmit e zhdukurve nuk janë kontaktuar ose informuar. Misioni duhet të ketë kryer vlerësimin dhe hetimin e tyre dhe të mos bazojë vendimet e tyre se a të fillojë ndonjë hetim mbi atë informacion që mund të kishte qenë tashmë në një dosje të UNMIK-ut.
73. Për më tepër, Paneli vëren se janë bërë pak ose aspak përpjekje në raste të këtij lloji dhe veçanërisht në këtë rast, për t'iu drejtuar institucioneve dhe organizatave të tjera (të tilla si ICRC; ICTY; OJQ; autoriteteve shtetërore) të cilat mund të ketë pasur informacione në dispozicion të tyre në lidhje me këto raste ose ekspertizë të rëndësishme për të ndihmuar përpjekjet hetimore të Misionit.
74. Prandaj, para se të vendoste që të mos hetonjë donjë lëndë, Misioni duhej të priste të shteroheshin të gjitha rrugët e arsyeshme të informacionit, duke përfshirë kontaktimin me të afërmit e të zhdukurve për të konstatuar nëse ata posedonin informacione të rëndësishme në lidhje me rastin.
75. Paneli hedh poshtë pohimin e pabazuar dhe të paverifikuar të Misionit se një hetim në lidhje me këtë rast nuk do të kishte të ngjarë të çonte në zbulimin e provave të reja ose në vërtetimin e së vërtetës. Vetëm një përpjekje e vërtetë dhe efektive për të sqaruar këtë çështje do të kishte siguruar një verifikim të vlefshëm për atë pohim.
76. Më në fund, Paneli vëren se aftësia e Misionit për të hetuar raste të këtij lloji u zvogëlua më tej me vendimin e shteteve të BE-së në vitin 2014 për të fshirë aftësinë e tij të inteligjencës dhe kërkimit (shih *supra*, paragrafi 25). Kur vendoset një mision i sundimit të ligjit me përgjegjësi për të hetuar çështje komplekse kriminale, siç ishte rasti këtu, është përgjegjësi e shteteve dhe organeve kompetente të BE-së të sigurojnë që Misioni të pajiset me të gjitha burimet e nevojshme për të përmbushur detyrat e tij në mënyrë efektive dhe në një mënyrë në përputhje me detyrimet e tij ndaj të drejtave të njeriut.

*Shpërndarja e informacionit ndërmjet organeve të Misionit*

77. Një aspekt i veçantë i mos veprimit të Misionit në përputhje me standardet e pritura të kujdesit të duhur në kryerjen e detyrimeve të tij hetimore ka të bëjë me dështimin e tij për të siguruar që informacionet në dispozicion të njërës prej organeve të tij të shpërndareshin me të gjitha organet e tjera përkatëse brenda Misionit.
78. Misioni ka përshkruar se si ishte praktika e zakonshme e organeve të Misionit që të përpiqeshin të bashkërendonin përpjekjet për të shkëmbyer informacione që kishin të bënin me raste të tilla. Sidoqoftë Misioni nuk ishte në gjendje të shpjegonte pse kjo nuk duket në të vërtetë në këtë rast dhe posaçërisht pse dosjet në posedim të Institutit të Mjekësisë Ligjore nuk kishin ra në zotërim të autoriteteve hetimore dhe prokuroriale të Misionit.
79. Kjo dështim për të bashkërenduar në mënyrë të duhur gjërat brenda Misionit dhe për të siguruar që mekanizmat dhe procedurat të zbatoheshin për të siguruar centralizimin e informacionit të ndjeshëm që i përket këtij lloji të rasteve, ka kontribuar në një situatë kur prokurorët e PSRK-së morën një vendim që të mos hetonin këtë rast pa njohuri të plotë se çfarë informacioni kishte në zotërim të Misionit në kohën përkatëse. Masat e duhura mbrojtëse duhej të ishin krijuar për të shmangur një situatë të tillë. Shih gjithashtu *Rejhane Sadiku-Syla kundër EULEX-it*, lënda nr. 2014-34, Vendimi për pranueshmërinë, 29 shtator 2015, paragrafët 60-61; dhe *Rejhane Sadiku-Syla kundër EULEX-it*, lënda nr. 2014-34, Vendimi dhe Gjetjet, 19 tetor 2016, paragrafët 39-40.

#### *Informimi i të afërmeve rreth personit të zhdukur*

80. Për shkak të efektit të veprave të zhdukjes me forcë ndaj të afërmeve të një të zhdukuri, është me rëndësi thelbësore që ata të përfshihen në hetimin e rasteve të tilla në masën më të madhe të mundshme. *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe Gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 66.
81. Nga autoritetet hetimore kërkohet si çështje e ligjit të të drejtave të njeriut që t'i mbajnë viktimat e shkeljeve të tilla të informuara për rrjedhën e hetimit të tyre. Në të vërtetë, kjo kërkon që ata të balancojnë të drejtat dhe interesat e viktimave për t'u informuar rreth përparimit të hetimit me shkallën e nevojshme të konfidencialitetit që një hetim mund të kërkojë në mënyrë të ligjshme. Duke iu nënshtruar konsideratave legjitime të konfidencialitetit dhe sigurisë, viktimat kanë të drejtë të përfshihen sa duhet dhe të informohen për procesin e hetimit. Përderisa karakteri i saktë i asaj që duhet t'u sigurohet atyre është e vështirë të përcaktohet në mënyrë abstrakte, informacioni i dhënë atyre që janë drejtpërdrejt të interesuar nga hetimi duhet të jetë i tillë që t'i mundësojë atyre që t'i bind ata se lënda po shqyrtohet siç duhet dhe se po bëhen të gjitha përpjekjet e rëndësishme dhe të arsyeshme për të vendosur fatin e të afërmeve të tyre dhe për të identifikuar ata që janë përgjegjës për të. Në përgjithësi shih *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe Gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 66; *Desanka dhe Zoran Stanisić kundër EULEX-it*, 2012-22, 11 nëntor 2015, par. 66; *L.O. kundër EULEX-it*, 2014-32, 11 nëntor 2015, par. 60-61, 72-73; PShDNj, Shënim i Ligjit mbi Detyrën për Hetimin e Akuzave të Shkeljeve të të Drejtave, faqe 28-30; shih gjithashtu *Ahmet Kanzkan dhe të tjerët kundër Turqisë*, Aplikacioni nr. 21689/93, Aktgjykimi i GjEDNj-së i datës 6 Prillit 2004, par. 311-314, *Isayeva kundër Ruisë*, Aplikacioni nr. 57950/00, Aktgjykimi i GjEDNj-së, paragrafët 24 shkurt 2005. 211-214; *Al-Skeini dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aplikacioni nr. 55721/07, Aktgjykimi i GjEDNj-së i datës 7 korrik 2011, par. 167.
82. Ky detyrim për t'i mbajtur të informuar viktimat në lidhje me përpjekjet hetimore është veçanërisht i rëndësishëm në një rast që përfshin akte të zhdukjes me forcë pasi të afërmit e mbijetuar mund të mos kenë asnjë burim tjetër informacioni në lidhje me fatin e të afërmit/afërmeve të tyre dhe ata do të vazhdojnë të jetojnë me shpresën që fati i të

afërmit/afërmve të tyre një ditë do të sqarohet. Si rezultat, të afërmit e afërt të viktimave të zhdukur vuajnë emocionalisht nga mungesa e informacionit në lidhje me fatin e të dashurit të tyre. Shih *Zufe Miladinović kundër EULEX-it*, 2017-02, 19 qershor 2019, par. 87; *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe Gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 78. Një kërkesë e tillë është një element i domosdoshëm i mbrojtjes së të drejtave të viktimave në hetimin e një rasti të tillë. Shih p.sh. *H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe Gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 77; *Desanka dhe Zoran Stanisić kundër EULEX-it*, 2012-22, 11 nëntor 2015, para. 66, duke iu referuar *L.O. kundër EULEX-it*, 2014-32, 11 nëntor 2015, par. 60-61, 72-74; *Zufe Miladinović kundër EULEX-it*, 2017-02, 19 qershor 2019, par. 86; shih gjithashtu *Ahmet Kanzkan dhe të tjerët kundër Turqisë*, Aplikacioni nr. 21689/93, Aktgjykimi i GjEDNj-së i datës 6 prill 2004, par. 311-314, *Isayeva kundër Rosisë*, Aplikacioni nr. 57950/00, Aktgjykimi i GjEDNj-së, paragrafët 24 shkurt 2005. 211-214; *Al-Skeini dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aplikacioni nr. 55721/07, Aktgjykimi i GjEDNj-së i datës 7 korrik 2011, par. 167. Dhe autoritetet kompetente nuk do të lejohen që lehtësisht të mosrespektojnë ose injorojnë atë. Shih *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe Gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 67.

83. Po ashtu e rëndësishme në këtë kontekst është e drejta e viktimës për të vërtetën, e cila buron nga kategoritë e tjera të njohura të të drejtave të njeriut. Duke nënvizuar të drejtën e viktimave për të vërtetën në këtë kontekst, Komenti i Përgjithshëm i Grupit të Punës për Zhdukjen me Forcë për këtë çështje thotë si më poshtë:

“Neni 13 i Deklaratës njeh detyrimin e Shtetit për të hetuar rastet e zhdukjeve me forcë. Paragrafi 4 i nenit 13 specifikon se “gjetjet e një hetimi të tillë do të vihen në dispozicion sipas kërkesës për të gjithë personat e interesuar, përveç nëse veprimi i tillë do të rrezikonte një hetim penal në vazhdim”. Në bazë të zhvillimeve që kanë ndodhur që nga viti 1992, Grupi i Punës gjykon që kufizimi në pjesën e fundit të këtij paragrafi duhet të interpretohet ngushtë. Në të vërtetë, të afërmit e viktimave duhet të lidhen ngushtë me një hetim për një rast të zhdukjes me forcë. Refuzimi për të dhënë informacion është një kufizim i së drejtës mbi të vërtetën. Një kufizim i tillë duhet të jetë rreptësisht proporcional me qëllimin e vetëm të ligjshëm: të shmangë rrezikimin e një hetimi penal në vazhdim e sipër. Një refuzim për të dhënë ndonjë informacion, ose për të komunikuar fare me të afërmit, me fjalë të tjera një refuzim i plotë, është një shkelje e së drejtës për të vërtetën. Sigurimi i informacionit të përgjithshëm për çështjet procedurale, siç është fakti që lënda i është dhënë një gjykatësi për shqyrtim, është i pamjaftueshëm dhe duhet të konsiderohet shkelje e së drejtës mbi të vërtetën. Shteti ka për detyrë të njoftojë çdo person të interesuar rreth hapave konkretë të ndërmarrë për të sqaruar fatin dhe vendndodhjen e personit. Një informacion i tillë duhet të përfshijë hapat e ndërmarrë në bazë të dëshmive të siguruara nga të afërmit ose dëshmitarët e tjerë. Ndërsa domosdoshmëria e një hetimi penal mund të justifikojë kufizimin e bartjes së ndonjë informacioni të caktuar, duhet të ketë një mjet juridik në legjislacionin shtetëror për të rishikuar një refuzim të tillë për të dhënë informacionin për të gjithë personat e interesuar. Ky rishikim duhet të jetë në dispozicion në kohën e refuzimit fillestar për të dhënë informacion, dhe pastaj në mënyrë të rregullt për të siguruar që arsyeja e nevojës që u kërkua nga autoriteti publik të refuzojë të komunikojë, të mbetet e pranishme”.

Shih *Komentin e Përgjithshëm e të Drejtës mbi të Vërtetën në Marrëdhënien ndaj Zhdukjes sme forcë, Raporti i Grupit të Punës për Zhdukjet me forcë ose të pavullnetshme (2010), Dokumenti A/HRC/16/48, paragrafi 3; Zufe Miladinović kundër EULEX-it*, 2017-02, 19 qershor 2019, par. 87; dhe gjithashtu lënda *I e Rio Negro Massacres kundër Guatemalës* (IACTHR) (Aktgjykimi i datës 04.09.2012, kundërshtimi

paraprak, kundërshtimi, meritat, riparimi dhe kostot), par. 265. Shih gjithashtu *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe Gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 78.

84. Në lidhje me lëndën në fjalë, nuk ka asnjë indikacion në të dhënat e Misionit që ai ka përmbushur detyrimin e tij për të informuar ankuesin për ekzistencën, rrjedhën dhe karakterin e hetimit.
85. Misioni nuk ka dhënë ndonjë shpjegim në lidhje me dështimin e tij për të mbajtur ankuesin (ose ndonjë të afërm të ngushtë të viktimës parësore) të informuar në lidhje me këtë rast. Në përgjigje të pyetjes së Panelit në atë pikë, Misioni tha si vijon:

‘Në përgjithësi, Misioni duhet të kishte bërë më shumë përpjekje për të mbajtur viktimat dhe publikun më të gjerë të informuar në lidhje me strategjitë dhe qasjet e tij, me qëllim që t’i menaxhojë pritjet në mënyrë sa më të duhur dhe të jetë më transparent. Sidoqoftë, në rastin konkret dhe duke marrë në konsideratë pengesat themelore të paraqitura, Misioni nuk beson se të drejtat e ankuesit janë shkelur dhe në bazë të asaj çfarë u ërmend më lart pohon se Misioni ka bërë atë që ishte e mundur në mënyrë të arsyeshme për të konstatuar fatin e Milorad Trifunović-it.

86. Detyrimi i Misionit ndaj kësaj kategorie të viktimave nuk ka të bëjë me "strategji" ose "qasje". As nuk bëhet fjalë për qasje. Kjo i përket të drejtës së viktimave të një shkeljeje të tillë të të drejtave të tyre për t’u informuar posaçërisht për atë që autoritetet po bëjnë për të sqaruar çështjen dhe për t’i sjellë ata që janë përgjegjës para drejtësisë. Duke mos rënë në kontakt me ankuesin dhe madje duke mos u përpjekur të bënte këtë, Misioni në të vërtetë ka shkelur të drejtat e tij.
87. Mosarritja e Misionit për të kontaktuar dhe njoftuar ankuesin për vendimin e tyre për të mos hetuar këtë rast, kontribuoi në shkeljen e të drejtave të ankuesit për aq sa shtoi gjendjen e pasigurisë në të cilën ai e gjeti veten gjatë gjithë periudhës përkatëse.

### **Mandati i ri, i reduktuar i Misionit që nga qershori 2018**

88. Mandati i ri i Misionit, i cili hyri në fuqi në qershor 2018, ka zvogëluar ndjeshëm aftësinë e Misionit për të ndikuar në hetimin e lëndëve penale, duke përfshirë edhe këtë. Roli i tij monitorues nuk e lejon atë të kërkojë fillimin e një hetimi, as nuk i jep asaj kompetencë për të vendosur rrjedhën e tij. *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe Gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 96.
89. Paneli konsideron se ndryshimi i natyrës së mandatit të Misionit nuk ia heq Misionit detyrimin e tij për të korrigjuar sa më shumë të jetë e mundur efektet e shkeljeve për të cilat është përcaktuar të jetë përgjegjës. Shih gjithashtu *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe Gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 99; dhe Vendimi i Këshillit (CFSP) 2018/856 i datës 8 qershor 2018.
90. Mbi atë bazë, Paneli do të rekomandojë që Misioni të ndërmarrë më tej hapa aktivë për të kërkuar nga autoritetet vendore kompetente se cilat masa, nëse ka ndonjë, po merren për të hetuar këtë rast dhe të raportojnë pranë autoriteteve kompetente në Bruksel nëse bëhet e qartë se autoritetet vendore nuk po i përmbushin detyrimet e tyre në lidhje me këtë. Duke dështuar në mbrojtjen e të drejtave të ankuesit, Misioni tani duhet të ndërmarrë hapa për të kërkuar që t’i korrihojë këto shkelje.

### **Pasojat mbi të drejtat e ankuesit**

91. Neni 2 i Konventës mbron një nga të drejtat më themeloret të njeriut, përkatësisht të drejtën e jetës. Kjo e drejtë mbrohet nën një larmi instrumentesh për të drejtat e njeriut

dhe ajo përbën një element thelbësor, themelor të mbrojtjes minimale të të drejtave të njeriut që i detyrohet çdo individ. Dihet vetëm për disa përjashtime të kufizuara. Shih në përgjithësi Komentin e Përgjithshëm nr. 36 (2018) për nenin 6 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, mbi të drejtën e jetës, CCPR/C/GC/36, 30 tetor 2018 ([https://tbinternet.ohchr.org/Treaties/CCPR/Shared%20Documents/1\\_Global/CCPR\\_C\\_GC\\_36\\_8785\\_E.pdf](https://tbinternet.ohchr.org/Treaties/CCPR/Shared%20Documents/1_Global/CCPR_C_GC_36_8785_E.pdf)) (këtu e tutje, "Komenti i Përgjithshëm 36"); *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe Gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 106.

92. Më e rëndësishmja për qëllimin këtu, kjo e drejtë nënkupton një detyrim procedural nga ana e shtetit ose autoritetit kompetent për të hetuar atje ku ata e dinë ose duhet të kenë ditur në lidhje me privimet potencialisht të paligjshme të jetës, për të hetuar dhe aty ku është e përshtatshme të ndjekë penalisht edhe incidente të tilla, përfshirë pretendimet për përdorim të tepërt të forcës me pasoja vdekjeprurëse. Në përgjithësi shih *Sadiku-Syla kundër EULEX-it*, 2014-34, Vendim dhe gjetje, 19 tetor 2016; *D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX-it*, 2014-11 deri 2014-17, Vendimi për pranueshmërinë, 30 shtator 2015; *Sadiku-Syla kundër EULEX-it*, 2014-34, Vendimi për pranueshmërinë, 29 shtator 2015; *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe Gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 107; shih gjithashtu *Nydia Erika Bautista de Arellana kundër Kolumbisë*, Komunikimi nr. 563/1993, Pamjet e Komitetit për të Drejtat e Njeriut, 27 tetor 1995 par. 8.6; *McCann dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykimi i GjEDNj-së i datës 27 shtator 1995, seria A nr. 324, par. 161; *Assenov dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, Aktgjykimi i GjEDNj-së i datës 28 tetor 1998, Raportet e vendimeve dhe vendimeve 1998-VIII, par. 102; *Nachova dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, nr. 43577/98 dhe 43579/98, Aktgjykimi i GjEDNj-së i datës 6 korrik 2005, par. 110; *Hugh Jordan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aplikacioni nr. 24746/94, Aktgjykimi i GjEDNj-së i datës 4 maj 2001, par. 105; Komenti i Përgjithshëm 36, par. 27; Këshilli për të drejtat e njeriut, Vërejtje përfundimtare: Kirgistan (2014), par. 13.
93. Hetimet dhe ndjekjet penale të privimeve potencialisht të paligjshme të jetës duhet të ndërmerren në përputhje me standardet përkatëse ndërkombëtare, duke përfshirë Protokollin e Minesotës për Hetimin e Vdekjes Potencialisht të Paligjshme (2016), dhe duhet që të kenë synim që të sigurohet se ata që janë përgjegjës të nxirren para drejtësisë, në promovimin e përgjegjësisë dhe parandalimin e mosndëshkimit, në shmangien e mohimit të drejtësisë dhe në nxjerrjen e mësimëve të nevojshme për rishikimin e praktikave dhe politikave me qëllim të shmangies së përsëritjes së shkeljeve. Në përgjithësi shih Komentin e Përgjithshëm 36, paragrafin 27 dhe referencat e cituara; dhe *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe Gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 108.
94. Po ashtu i rëndësishëm për këtë rast është neni 3 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, i cili parasheh që askush nuk duhet t'i nënshtrohet torturës ose trajtimit ose dënimit çnjerëzor dhe poshtëruës. Një ndalim dhe garanci e ngjashme parashihet në shumë instrumente të tjera të të drejtave të njeriut, përfshirë nenin 7 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Nenin 2 të Konventës Kundër Torturës dhe Trajtitimit ose Ndëshkimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore ose Poshtëruese. Kjo është përsëri një e drejtë themelore me një rëndësi të jashtëzakonshme që duhet të mbrohet në çdo kohë dhe në çdo rrethanë.
95. Është pranuar në jurisprudencën e Panelit dhe në praktikën e organeve të tjera të të drejtave të njeriut se trauma emocionale e të afërmit e një të zhdokuri që vjen nga mungesa e informacionit në lidhje me fatin e të afërmit të tyre mund të arrijë në pragun e seriozitetit të kërkuar për këtë garanci. Shih p.sh. *L.O. kundër EULEX-it*, 2014-32, Vendim dhe gjetje, 11 nëntor 2015; *D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX-it*, 2014-11 deri 2014-17, Vendimi për pranueshmërinë, 30 shtator 2015;

*Sadiku-Syla kundër EULEX-it*, 2014-34, Vendim dhe gjetje, 19 tetor 2016; *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe Gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019. Shih gjithashtu Deklaratën për Mbrojtjen e të gjithë Personave nga Zhdukja me forcë, paragrafi i 5të i Parathënies (duke përmendur se zhdukja me forcë shkakton “ankth dhe pikëllim”) dhe nenin 1 (2) i cili parasheh që “çfarëdo akti i zhdukjes me forcë (...) përbën shkelje të rregullave të së drejtës ndërkombëtare që garantojnë, (...) e drejta për të mos iu nënshtruar torturave dhe trajtimeve ose dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese”), dhe Komenti i Përgjithshëm për të drejtën e së vërtetës në lidhje me zhdukjen me forcë, Raporti i Grupit të Punës për Zhdukjet me Forcë ose të Pavullnetshme, 2010. Dokumenti A/HRC/16/48, par. 4.

96. Sipas këndvështrimit të Panelit, dështimi i Misionit për të) bashkërenduar në mënyrë të duhur ndërmjet organeve të tij për të siguruar që të gjitha informacionet përkatëse të shpërndahen përpara se të merrej një vendim që mos të hetohet ky rast, b) për t'i mbajtur të informuar të afërmit në lidhje me veprimet e Misioni rreth këtij rasti, dhe c) të përdorë të gjitha mjetet e mundshme hetimore në përpjekje për të zgjidhur këtë rast, të gjitha këto kanë kontribuar në shkeljen e të drejtave të ankuesit sipas nenit 2 të Konventës që kjo lëndë të hetohet plotësisht dhe me zell nga Misioni.
97. Këto dështime dhe lëshime gjithashtu kanë kontribuar në shkeljen e të drejtave të ankuesit sipas nenit 3 të Konventës dhe kanë kontribuar në traumën emocionale dhe psikologjike që rezultuan nga mos dija se çfarë i kishte ndodhur vëllait të tij. Ajo traumë është e rëndë, konstante dhe e vazhdueshme. Natyrisht, nuk është ekskluzivisht pasojë e veprimit të Misionit, por Paneli nuk është kompetent për të dhënë përcaktime në lidhje me përgjegjësinë e UNMIK-ut në këtë drejtim. Në çdo rast, dështimi i UNMIK-ut, sado serioz, nuk do të justifikonte vetë Misionin. Prandaj, gjetjet e bëra këtu janë të kufizuara në ato veprime dhe dështime të Misionit që kanë kontribuar në shkeljen e të drejtave të ankuesit dhe ato të vëllait të tij, duke marrë parasysh sfidat e përshkruara më lart me të cilat Misioni ishte ballafaquar në atë kohë.
98. Sidoqoftë Paneli rithekson se Misioni në këtë rast ka investuar kohë dhe burime jo të parëndësishme për t'u përpjekur që të gjente të afërmin e ankuesit ose eshtrat e tij.
99. Në bazë të gjetjeve të bëra më lart në lidhje me nenet 2 dhe 3 të Konventës, Paneli nuk mendon se duhet të bëjë gjithashtu edhe gjetje në lidhje me nenet 8 dhe 13 të Konventës. Megjithatë Paneli vëren se përderisa interesat e mbrojtura nga secila dispozitë ndërthuren me njëra tjetrën pjesërisht, ato nuk janë identike. Për më tepër, Paneli thekson se veprimi që i ngarkohet Misionit duket se *prima facie* ka ndikuar negativisht në të drejtat e ankuesit për jetën familjare dhe të drejtën e tij për një mjet efektiv juridik. Paneli nuk do të bëjë gjetje përfundimtare në lidhje me këto të drejta, pasi gjetjet e tij në lidhje me nenet 2 dhe 3 përmbajnë ato që i konsideron si tiparet thelbësore të shkeljeve që i janë ngarkuar Misionit.
100. Bazuar në atë që u përmend më sipër, Paneli ka përcaktuar se Misioni ka shkelur të drejtat e ankuesit sipas nenit 2 (pjesa procedurale) dhe nenin 3 të Konventës.

## **PËR KËTO ARSYE, PANEL NJËZËRI**

**KONSTATON** se Misioni ka shkelur të drejtat e ankuesit ashtu siç garantohej me nenin 2 (pjesa procedurale) dhe 3 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut;

**NË BAZË TË KËSAJ, PANELI NUK E KONSIDERON TË NEVOJSHME** që të bëjë gjetje në lidhje me shkeljet e mundshme nga Misioni të neneve 8 dhe 13 të Konventës;

**VËREN** se në bazë të të dhënave në dispozicion të Panelit, shkelja e së drejtës së ankuesit mund të jetë duke vazhduar, dhe për këtë arsye,

**REKOMANDON** si vijon:

- i. Duke marrë parasysh peshën e shkeljeve në shqyrtim e sipër, Paneli fton shefin e Misionit të shqyrtojë me kujdes mundësinë dhe nevojën që Misioni të pranojë shkeljen e të drejtave të ankuesit të kryer nga ana e Misionit;
- ii. Paneli fton Misionin të sigurojë që dosja e lëndëve që kanë të bëjnë me këtë lëndë dhe këtë vendim të dërgohen tek autoritetet vendore kompetente;
- iii. Paneli rekomandon që kjo lëndë t'i nënshtrohet monitorimit nga ana e Misionit;
- iv. Paneli rekomandon që, ashtu siç ndodhi në lëndën 2017-02, Misioni duhet të konsiderojë që t'i bëjë rekomandime autoriteteve rreth rrjedhës së mundshme hetimore në të ardhmen që mund të ndihmojë në zgjidhjen e këtij rasti; në këtë kontekst, Paneli rekomandon që Misioni të theksojë rëndësinë e të drejtave të viktimave për të vërtetën dhe të informohet për rrjedhën e përgjithshme të hetimit;
- v. Paneli rekomandon që Misioni të raportojë tek autoritetet kompetente në Bruksel nëse bëhet e qartë se autoritetet vendore nuk po i përmbushin detyrimet e tyre në lidhje me këtë;
- vi. Misioni duhet të ndërmarrë hapa aktivë për të kërkuar nga autoritetet se cilat hapa, nëse ka ndonjë, po merren për të hetuar këtë rast dhe për t'u raportuar autoriteteve kompetente të Bashkimit Evropian në Bruksel, nëse bëhet e qartë se autoritetet nuk po përmbushin detyrimet e tyre në këtë drejtim;
- vii. Paneli rekomandon që ky vendim duhet t'iu ofrohet organeve përkatëse të Misionit; dhe
- viii. Paneli gjithashtu rekomandon që shefi i Misionit të sigurojë që aktivitetet e monitorimit të Misionit të zhvillohen në atë mënyrë që është përputhje me detyrimet e Misionit ndaj të drejtave të njeriut dhe të siguroj që kjo pjesë e mandatit të tij të kontribuojë në mbrojtjen dhe promovimin efektiv të atyre të drejtave.

**PANELI KËRKON NGA MISIONI** të raportojë mbi zbatimin e këtyre rekomandimeve sa më shpejt që është e mundur, por jo më vonë se data 16 mars 2020.

Për Panelin,

Guénaél METTRAUX  
Kryesues

Anna BEDNAREK  
Anëtare

Anna AUTIO  
Anëtare